



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 59/2 Prot.

Tiranë, më datë 24.01.2023

VENDIM
Nr. 20, datë 24.01.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.01.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Impianti fotovoltaik, Erseka Solar Park 2”, Starje - Ersekë, Bashkia Kolonjë.”, me aplikues Gjergj Vinjahu dhe zhvillues “Favina” sh.p.k, “Favina 1” sh.p.k, “M&K Energy Trading CO” sh.p.k.;
 2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin, si dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit ;
 3. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore;
 4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Eugen KALLFANI

